



LËVIZJET EKONOMIKE AFATSHKURTRA



Nëntor, 2024



PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJA	2
1. SEKTORI REAL.....	3
Prodhimi industrial	3
Numri i të punësuarve në industri.....	4
Çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor	5
Indekset e qarkullimit industrial	5
Numri i lejeve të ndërtimit të dhëna dhe vlera e paraparë e objekteve	6
Numri i punëve ndërtimore të kryera sipas llojeve të objekteve.....	7
Qarkullimi në sektorin e tregtisë.....	8
Inflacioni	8
Çmimet e bursës	10
2. SHKËMBIMI I TREGTISË SË JASHTME.....	12
Eksporti	12
Importi	13
Bilanci	14
Struktura e valutës	15
3.SEKTORI FISKAL	15
Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik.....	15
Tabela 3.1. Realizimi i Buxhetit të RMV-së për periudhën janar - nëntor të vitit 2024	16
Shpenzime sipas shfrytëzuesve buxhetorë.....	17
4. SEKTORI SOCIAL.....	19
Personat e sapopunësuar dhe të regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit	19
Pagat	19
Pensionet	20
5. SEKTORI MONETAR FINANCIAR	21
Paratë primare.....	22
Potenciali i depozitave	22
Kreditë bankare	23
Normat e interesit të depozitave bankare.....	23
Tregu i kapitalit	24
Rezervat devizore	24



PËRMBLEDHJA

E ZHVILLIMEVE MË TË RËNDËSISHME EKONOMIKE AFATSHKURTRA

nëntor, 2024

- Në muajin nëntor të vitit 2024, prodhimi industrial ka shënuar rënie prej 3.5%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprakë;
- Në muajin nëntor të vitit 2024, çmimet e shitjes së produkteve industriale të prodhuesve në tregun vendor janë më të larta për 5.6%, krahasua me muajin e njëjtë të vitit të kaluar;
- Qarkullimi në industri në muajin nëntor të vitit 2024, krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023, shënoi rënie për 7.5%;
- Norma e inflacionit në muajin nëntor të vitit 2024 është 4.3% në nivel vjetor dhe në këtë muaj inflacioni shënon përsheptim rritjeje (3.5% në muajin tetor të vitit 2024). Në nivel mujor, inflacioni shënon rritje prej 1.0%;
- Gjatë periudhës janar – nëntor të vitit 2024, eksporti ka shënuar rënie prej 5.8%, ndërsa importi ka shënuar rënie prej 0.6%, që ka rezultuar me rritjen e deficitit tregtar për 15.3%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023;
- Gjatë periudhës janar – nëntor të vitit 2024, realizimi i të ardhurave të përgjithshme buxhetore të Buxhetit të RMV-së është 277.082 milionë denarë, që paraqet 87.1% të vlerës së planifikuar për vitin 2024, përkatësisht rritje për 11.5%, krahasuar me të hyrat e realizuara buxhetore, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2023;
- Gjatë periudhës janar – nëntor të vitit 2024, realizimi i shpenzimeve të përgjithshme është 306.738 milionë denarë, që paraqet 84.5% të planit vjetor, përkatësisht rritje prej 10.8%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023;
- Në muajin nëntor të vitit 2024, kreditë e përgjithshme të bankave janë rritur për 9.7%, krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023, ndërsa potenciali i përgjithshëm i depozitave të bankave ka shënuar rritje prej 11.0%.



1. SEKTORI REAL

Prodhimi industrial



Në muajin nëntor të vitit 2024, prodhimi industrial ka shënuar rënie prej 3.5%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar. Rënia vjen si rezultat i rënies së prodhimit në të gjithë sektorët, si në atë të sektorit të minierave dhe gurorëve për 3.2%, industrinë e përpunimit për 2.7% dhe furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 6.7%.

Rritje e prodhimit në muajin nëntor të vitit 2024, krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023 shënojnë 10 prej 27 sektorëve industrialë që përfshijnë 24.9% të industrisë së përgjithshme.

Nga sektorët me vlerë të shtuar më të lartë, në muajin nëntor të vitit 2024 rritje kanë shënuar sektorët: prodhimi i pajisjeve elektrike prej 28.2% me kontribut prej 1.5 p.p. dhe prodhimi i metaleve prej 5.6% me kontribut prej 0.3 p.p., ndërsa rënie kanë shënuar sektorët: prodhimi i automjeteve, rimorkiove dhe gjysmë-rimorkiove prej 10.2% me kontribut prej -1.3 p.p. dhe prodhimi i makinerive dhe pajisjeve prej 16.7% me kontribut prej -1.1 p.p..


Nga sektorët tradicional në muajin nëntor të vitit 2024, shënohet rritje e prodhimit në sektorët e mëposhtëm: prodhimi i produkteve të duhanit për 144.4% me kontribut prej 1.8 p.p. dhe përpunimi i drurit dhe produkteve të drurit dhe tapave për 39.9% me kontribut prej 0.3 p.p., ndërsa ulja e prodhimit shënohet në sektorët: prodhimi i lëkurës për 3.9% me kontribut prej 0.0 p.p., prodhimi i rrobave për 12.4% me kontribut prej -0.8 p.p., prodhimi i pijeve për 2.8% me kontribut prej -0.1 p.p., prodhimi i tekstilit për 5.8% me kontribut prej -0.3 p.p. dhe industria e përpunimit të ushqimeve për 7.5% me kontribut prej -0.8 p.p..

Prodhimi industrial sipas destinimit të njësisë të prodhuara në muajin nëntor të vitit 2024, krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023, është ulur në grupet e mëposhtme: energjia (rënie prej 6.6% me kontribut prej -0.8 p.p.), produktet kapitale (rënie prej 11.1% me kontribut prej -2.6 p.p.) dhe produktet me afat të shkurtër skadence për konsum të gjerë (rënie prej 6.9% me kontribut prej -2.1 p.p.), ndërsa prodhimi ka shënuar rritje te grupet: produktet intermediare, përveç energjisë (rritje prej 4.3% me kontribut prej 1.3 p.p.) dhe produkte me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë (rritje prej 36.2% me kontribut prej 1.3 p.p.).






Grafiku 1.3a: Degët me kontributin pozitiv të rritjes
(normat e rritjes në % nëntor 2024)



1 - Prodhimi i produkteve të duhanit
2 - Prodhimi i pajisjeve elektrike
3 - Industri të tjera prodhuese
4 - Prodhimi i mobiljeve
5 - Prodhimi i produkteve metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve

Burimi: ESHS

Grafiku 1.3b: Degët me kontributin negativ të rritjes
(normat e rritjes në % nëntor 2024)



1 - Prodhimi i automjeteve, rimorkiove dhe gjysmërimorkiove
2 - Prodhimi i makinave dhe pajisjeve, të paspecifikuara diku tjetër
3 - Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar
4 - Prodhimi i veshjeve
5 - Prodhimi i produkteve ushqimore


Burimi: ESHS

Sipas destinimit të njësive të prodhuara, rritje gjatë periudhës janar – nëntor të vitit 2024 është shënuar në grupet: produkte me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë (për 10.2%), në grupin produkte kapitale nuk ka ndryshim, ndërsa rënie është shënuar në sektorët e mëposhtëm: energjia (për 18.4%), prodhimi intermediar, përveç energjisë (për 1.9%) dhe produkte me afat të shkurtër skadence për konsum të gjerë (për 4.1%).

Numri i të punësuarve në industri

Në muajin nëntor të vitit 2024, numri i të punësuarve në industri ka shënuar rënie prej 4.0%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia vjen për shkak të numrit të reduktuar të të punësuarve në sektorin e industrisë së përpunimit për 4.7%, ndërsa rritja shënohet në sektorët: minierave dhe gurorëve për 4.9%, si dhe furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 1.1%. Rritja e numrit të të punësuarve shënohet në sektorët e prodhimit të makinerive dhe pajisjeve, të përmendur në ndonjë vend tjetër për 34.0%, prodhimi i pijeve për 12.1% dhe nxjerrja e thëngjillit dhe linjtit për 11.8%.

Grafiku 1.4: Punësimi dhe produktiviteti në industri
(normat e rritjes në %)



Burimi: ESHS; përilogaritja e MF-së

Të dhënat për numrin e të punësuarve në industri sipas grupeve të destinimit në muajin nëntor të vitit 2024, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, tregojnë se rritje e të të punësuarve shënojnë grupet: energjia për 4.5% dhe produktet me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë për 24.6%.

Të dhënat kumulative tregojnë se numri i punëtorëve në industri gjatë periudhës janar – nëntor të vitit 2024 shënuan rritje për 0.1% si rezultat i rritjes së numrit të punëtorëve në sektorët: miniera dhe gurorëve për 5.1% dhe furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 0.9%, ndërsa rënie shënohet në sektorin e industrisë së përpunimit për 0.2%.

Sa i përket grupeve të destinuara, numri i të të punësuarve në industri gjatë periudhës janar – nëntor të vitit 2024 ka shënuar rritje në sektorët: energjia për 4.5%, produkte kapitale për 11.6% dhe produktet me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë për 16.0%.



Çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor

Në muajin nëntor të vitit 2024, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor ishin për 5.6% më të larta, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja vjen si pasojë e rritjes së çmimeve në sektorët: industria e përpunimit për 4.2%, furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 14.3% dhe furnizimi me ujë; trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e sanimit të mjedisit për 4.5%, ndërsa në sektorin e minierave dhe guroreve çmimet e shitjes u ulën për 1.7%.

Në muajin nëntor të vitit 2024, krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor janë më të larta në grupet: energjia për 13.1%, produktet e konsumit të gjërë për 8.1%, produktet me afat të gjatë skadence për 5.1%, dhe produktet me afat të shkurtër skadence për 8.2%.


Në bazë kumulative, në periudhën janar - nëntor të vitit 2024 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor janë më të larta për 2.2%, kjo vjen si pasojë e rritjes së çmimeve në sektorët: industria e përpunimit për 1.3%, furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 6.8% dhe furnizimi me ujë; trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e sanimit të mjedisit për 2.9%, ndërsa çmimet e shitjes u ulën në sektorin e minierave dhe guroreve për 1.2%.

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2024 krahasuar me janar - nëntor të vitit 2023, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor janë më të larta në grupet: energjia për 6.4%, produkte të konsumit të gjërë për 5.9%, produkte me afat të gjatë skadence me 4.3% dhe produkte me afat të shkurtër skadence për 6.0%.


Indekset e qarkullimit industrial

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, qarkullimi industrial në muajin nëntor të vitit 2024 është ulur për 7.5% krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023. Rënia vjen si pasojë e uljes së


Grafiku 1.5: Rritja e çmimeve të shitjes së prodhimeve industriale në tregun vendor sipas sektorëve



Grafiku 1.6: Rritja e çmimeve të shitjes së prodhimeve industriale në tregun vendor sipas grupeve



Grafiku nr.1.7: Rritja e qarkullimit në industri në grupet kryesore industriale





qarkullimit në sektorin e industrisë së përpunimit për 8.2%, ndërsa qarkullimi në sektorin e minierave dhe guroreve është rritur për 14.3%.

Në muajin nëntor të vitit 2024, krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023, qarkullimi industrial është rritur në grupet: produkte intermediare, përveç energjisë për 3.0%, produkte me afat të gjatë skadence për konsum të gjërë për 12.8% dhe produkte me afat të shkurtër skadence për konsum të gjërë për 2.9%.

Degët me rritjen më të lartë të qarkullimit industrial në muajin nëntor të vitit 2024, krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar janë:

- Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit (ritje prej 107.0%);
- Përpunimi i drurit dhe produkteve të drurit dhe tapave, përveç mobiljeve, prodhimi i artikujve prej kashte dhe materialeve thurëse (ritje prej 27.3%)
- Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve (ritje prej 21.5%).

Në bazë kumulative, në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, qarkullimi në industri është ulur për 10.8%, që vjen si pasojë e rënies së qarkullimit në sektorin e industrisë së përpunimit për 11.2%, ndërsa qarkullimi në sektorin e minierave dhe guroreve shënon rritje prej 1.1%.



Në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, krahasuar me periudhën janar - nëntor të vitit 2023, qarkullimi në industri është rritur në grupet: produkte me afat të gjatë skadence për konsum të gjërë për 2.9% dhe produkte me afat të shkurtër skadence për konsum të gjërë për 1.1%.

Numri i lejeve të ndërtimit të dhëna dhe vlera e paraparë e objekteve

Në muajin nëntor të vitit 2024 janë dhënë gjithsej 260 leje ndërtimi, që paraqet rënie prej 18.2% krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2023. Kjo vjen për shkak të rënies vjetore të lejeve të ndërtimit të lëshuara për objektet e larta për 9.4% (të cilat përbëjnë 59.6% të numrit të përgjithshëm të lejeve të ndërtimit të dhëna) dhe për rikonstruksionin e objekteve për 40.3%. Krahasuar me muajin tetor të vitit 2024, numri i lejeve të ndërtimit të dhëna ka rënë për 28.4%. Vlera e parashikuar e objekteve sipas lejeve të ndërtimit të dhëna në muajin nëntor të vitit 2024 është për 63.8% më e ulët në bazë vjetore dhe krahasuar me muajin paraprak ka shënuar rënie prej 49.8%.

Analizuar sipas llojit të objekteve, nga numri i përgjithshëm i lejeve të ndërtimit të dhëna, 155 (ose 59.6%) janë të destinuara për objekte të larta, 59 (ose 22.7%) për objekte të ulëta dhe 46 (ose 17.7%) për objekte rikonstruimi.

Analizuar sipas llojit të investitorit, nga gjithsej 260 leje ndërtimi të dhëna, 146






objekte (ose 56.1%) ishin në pronësi të personave fizikë, ndërsa 114 objekte (ose 43.9%) në pronësi të subjekteve afariste.


Me lejet e ndërtimit të lëshuara në muajin nëntor të vitit 2024 parashikohet ndërtimi i 542 banesave me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme prej 49.111 m². Numri i banesave të planifikuara për ndërtim është ulur për 40.6% në bazë mujore dhe për 17.3% në bazë vjetore.

Numri i punëve ndërtimore të kryera sipas llojeve të objekteve

Vlera e përgjithshme e punëve ndërtimore të kryera në muajin tetor të vitit 2024 arriti në 3.621 milionë denarë, që paraqet rritje nominale vjetore prej 5.7%, ku rritje ka në ndërtimin e objekteve të larta për 6.4%, në ndërtimin e objekteve të ulëta për 8.8%, ndërsa në punimet e specializuara të ndërtimit ka rënie prej 42.3%. Krahasuar me muajin shtator të vitit 2024, vlera e përgjithshme e punëve ndërtimore të kryera ka pasur rënie për 0.5%, si në ndërtimin e ndërtesave të larta për 17.7%, ndërsa rritje ka ndërtimi i ndërtesave të ulëta për 9.0%, dhe në punimet e specializuara ndërtimore për 9.8%. Në mënyrë kumulative, në periudhën janar - tetor të vitit 2024, vlera e punëve të kryera ndërtimore arriti në 27.296 milionë denarë, që është 7.6% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.



Në kuadër të punëve ndërtimore të kryera, pjesa më e madhe i referohet ndërtimit të ndërtesave të ulëta, ku në dhjetë muajt e parë të vitit janë kryer punë ndërtimore në vlerë prej 17.245 milionë denarëve, përkatësisht 21.9% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë kësaj periudhe, vlera e punëve të kryera në ndërtimin e ndërtesave të larta është ulur për 12.0% dhe ka vlerë prej 9.127 milionë denarëve, ndërsa në punimet e specializuara ndërtimore vlera e punëve të kryera është 924 milionë denarë, gjegjësisht 9.1% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.



Në bazë reale, vlera e punimeve të kryera ndërtimore në periudhën janar - tetor të vitit 2024 është rritur për 15.9%, me rritje në ndërtimin e ndërtesave të ulëta (31.3%) dhe punimeve të specializuara ndërtimore (17.5%), ndërsa në ndërtimet e ndërtesave të larta është shënuar rënie prej (5.3%).




Qarkullimi në sektorin e tregtisë

Në muajin nëntor të vitit 2024, të dhënat e tregtisë së brendshme tregojnë rritje nominale vjetore të qarkullimit prej 3.0%, pas rritjes prej 5.7% në muajin tetor. Vlera e qarkullimit në muajin nëntor të vitit 2024 është 68.773 milionë denarë, ndërsa në mënyrë kumulative, në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, vlera e qarkullimit të përgjithshëm tregtar arriti në 727.448 milionë denarë, që është 4.5% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kumulativisht, në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, rritje pozitive e qarkullimit është shënuar në të gjithë sektorët: tregtia me shumicë, vlera e qarkullimit të së cilës është 394.280 milionë denarë, përkatësisht 5.9% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, tregtia me pakicë, vlera e qarkullimit të së cilës është 289.410 milionë denarë, që është 3.1% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, dhe tregtia me automjete dhe riparime, vlera e qarkullimit të të cilave është 43.758 milionë denarë ose 1.6% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në bazë reale, në muajin nëntor të vitit 2024, tregtia me pakicë shënoi rënie vjetore prej 0.5%, ndërsa analizuar sipas grupeve dhe klasave, rritje është shënuar vetëm në grupin e tregtisë me pakicë të karburanteve për automjete për 6.0%, ndërsa rënie është vërejtur në grupet: tregtia me pakicë të produkteve joushqimore për 0.1% dhe tregtia me pakicë e ushqimeve, pijeve dhe duhanit për 4.5%.

Në muajin nëntor të vitit 2024, pjesëmarrje më të madhe strukturore në sektorin e tregtisë kishte njësia e tregtisë me shumicë (52,8%), ndjekur nga tregtia me pakicë (40,1%) dhe tregtia e automjeteve dhe motoçikletave, riparimi dhe mirëmbajtja e tyre (7,1%).

Grafiku 1.12: Tregtia me pakicë, ndryshimi real vjetor (%)




Inflacioni

Norma e inflacionit në muajin nëntor të vitit 2024 është 4.3% në nivel vjetor dhe ajo gjithashtu regjistroi përsheptim të rritjes këtë muaj (3.5% në muajin tetor të vitit 2024). Rritja e inflacionit këtë muaj në masë të madhe rezulton nga komponenti ushqimor, i cili shënoi rritje të përsheptuar dhe rritje të kontributit në inflacionin e përgjithshëm, ndërkohë që komponenti bazë shënoi ngadalësim të rritjes në muajin nëntor. Norma mesatare e inflacionit në periudhën janar - nëntor të vitit 2024 është 3.4%.

Në muajin nëntor të vitit 2024, inflacioni bazë (inflacioni pa ndikimin e çmimeve të ushqimeve dhe energjisë elektrike) shënoi ngadalësim të rritjes dhe arriti në 5.5% me bazë vjetore (6.0% muajin paraardhës). Kontribut më të madh pozitiv këtë muaj ka pasur rritja e çmimeve në kategorinë restorantet dhe hotelet (1.3 p.p.).

Grafiku 1.13: Inflacioni sipas COICOP (normal e rritjes në %)



Burimi: ESHS






Çmimet në kategorinë ushqime dhe pije joalkoolike shënuan përshejtim të rritjes këtë muaj dhe shënuan vlerën 5.7% (2.4 p.p. më i lartë se muaji paraprak), me ç'rast kontributi i kësaj kategorie në inflacionin e përgjithshëm në muajin nëntor është 2.3 p.p. dhe kontributi i tij është rritur krahasuar me muajin e kaluar. Kontributin më të madh pozitiv në rritjen e kategorisë ushqime dhe pije jo alkoolike kanë nënkategoritë: perime (rritje vjetore prej 15,6% dhe kontributi prej 0.7 p.p), qumështi, djathi dhe vezët (rritje vjetore prej 7.1%, kontributi prej 0.5 p.p), mishi (rritje vjetore prej 4.0%, kontributi prej 0.4 p.p) dhe pijet joalkoolike (rritje vjetore prej 12.9%, kontributi prej 0.3 p.p).

Shikuar sipas komponentëve, rritja më e lartë vjetore e çmimeve në muajin nëntor të vitit 2024 u shënuar në kategorinë restorante dhe hotele për 11.4% (kontribut në rritjen e inflacionit të përgjithshme prej 0.7 p.p).

Rritje të çmimeve janë regjistruar edhe në këto kategori: pijet alkoolike, duhani dhe narkotikët për 6.8%¹, rekreacion dhe kulturë për 5.8%, mbrojtje shëndetësore për 4.9%, mallra dhe shërbime të ndryshme për 4.1%, veshje dhe këpucë për 3.0%. Mobilje, amvisëri dhe mirëmbajtja e rregullt e amvisërive për 2.4%, komunikimet për 2.2%, banimi, uji, rryma, gazi dhe lëndët djegëse të tjera për 0.7% dhe Arsimi për 0.3%. Rënie e çmimeve prej 0.4% është shënuar në kategorinë transport.

Çmimet e konsumit edhe në muajin nëntor u rritën për 1.0% në nivel mujor (çmimet muajin e kaluar u ulën për 0.7%). Rritja e çmimeve në nivel mujor vjen si pasojë e rritjes së çmimeve të ushqimeve, me ç'rast rritja është ndikuar nga fakti se masat për uljen e marzheve për 73 produkte ushqimore, e



¹Çmimi i produkteve të duhanit është rritur në përputhje me ndryshimet e miratuara në Ligjin e Akcizave, akciza e cigareve do të rritet për 0.23 denarë për copë çdo vit deri në vitin 2030. Në muajin tetor të vitit 2024 u vendos çmimi i ri i duhanit.



ashtuquajtura “shporta e vjeshtës²”, pushoi së vlefshmi më 31 tetor.

Në muajin nëntor çmimet e ushqimeve janë rritur për 2.1% në nivel mujor, (kontribut pozitiv prej 0.9 p.p.) dhe kontribut më të madh në rritjen e çmimeve e ka patur mishi, buka dhe zarzavatet.

Në muajin nëntor të vitit 2024 çmimet me pakicë janë rritur për 4.0% në nivel vjetor dhe ato shënojnë përshpejtim rritjeje. Në bazë mujore, çmimet me pakicë kanë regjistruar rritje prej 0.3%. Në periudhën janar-nëntor çmimet me pakicë janë rritur me 3.7 në nivel vjetor.

Në Eurozonë, norma e inflacionit në muajin nëntor 2024 u rrit për 0.3 p.p. krahasuar me muajin tetor tetor dhe është 2.3%.

Në përputhje me projeksionet e BQE-së, norma e interesit në vitin 2024 duhej të arrijë 2.5, 2.2% në vitin 2025 dhe 1.9% në vitin 2026. Për vitin 2024 pritet që norma e inflacionit të lëvizë rreth 2.5% me jostabilitet të vazhdueshëm që vjen si shkak i efektit bazë të çmimeve të energjisë. Nuk pritet ndryshim i madh i inflacionit gjatë vitit 2024 dhe ai do të mbetet mbi mesataren historike që reflekton në rënien graduale të çmimeve të shërbimeve. Duke marrë parasysh se ulja e çmimeve të produkteve ushqimore pritet të vazhdojë dhe komponenti energjetik të ketë kontribut të vogël pozitiv në inflacionin e përgjithshëm, në tremujorin e katërt të vitit 2025 pritet të arrihet një ngadalësim i dezinflacionit dhe objektivit prej 2%.


Norma e inflacionit në muajin tetor të vitit 2024 ishte 3.5% në nivel vjetor dhe këtë muaj edhe një herë regjistroi përshpejtim të rritjes (2.6% në muajin shtator të vitit 2024). Rritja e inflacionit në pjesën më të madhe vjen si pasojë e komponnetit bazë, por këtë muaj ka shënuar edhe rritje të ndjeshme kompensimi i komponentit ushqimor në inflacionin e përgjithshëm, si dhe rritje në nivel vjetor. Norma messatare e inflacionit në periudhën janar-tetor të vitit 2024 ishte 3.3%.

Çmimet e bursës

Në muajin nëntor të vitit 2024, çmimi i naftës bruto (brent) në bursat botërore u ul për 1.7% në nivel mujor dhe ishte 74.4 dollarë për fuçi, për shkak të kombinimit të shumë faktorëve, përkatësisht rritjes së furnimizimit nga vendet që nuk janë pjesë e OPEK +, shqetësimi për rritjen ekonomike globale, veçanërisht në Kinë, që shënoi ulje të kërkesave të naftës, si dhe faktorëve gjeopolitikë. Në nivel vjetor çmimi i naftës është më i ulët për 11.1%.


Në muajin nëntor të vitit 2024, çmimi i gazit natyror është rritur për 3.8% në

Grafiku 1.17: Ndryshimi i çmimit të gazit natyror
(indeksi bazë; norma e rritjes në %)



Burimi: Banka Botërore; përlogaritjet e MF-së

Grafiku 1.18: Çmimet e metaleve në Bursë
(çmimet në dollar/ton)



Burimi: Banka Botërore

² Më 20 shtator, qeveria kufizoi marzhën e fitimit bruto të 73 produkteve me 10 për qind. E ashtuquajtura "shporta e vjeshtës" përfshinte bukë, produkte të furrës dhe produkte të qumështit, qumësht, mish dhe produkte mishi, një pjesë të konservave, fruta, perime, oriz, fasule, makarona. Masa ishte në fuqi deri më 31 tetor.



nivel mujor. Çmimi i gazit është nën ndikimin e disa faktorëve, mes të cilave edhe të tensioneve gjopolitike, përfshirja dhe eskalimi i konfliktit në Lindjen e Mesme dhe shqetësimit për ndërprerjen e mundshme të furnizimit në kufirin ruso-ukrainas për shkak të konfliktit të vazhdueshëm. Këta faktorë kanë rritur ankthin në tregun e gazit, me ç'rast rritet jostabiliteti. Në muajin nëntor të vitit 2024, çmimi i gazit natyror u ul për 9.0% në nivel vjetor.

Çmimi i energjisë elektrike në muajin nëntor të vitit 2024 sipas Bursës Hungareze të Energjisë Elektrike (HUPX) ishte 163.72 euro për megvat/orë dhe në nivel mujor u regjistrua rritje prej 77.6%. Çmimet e energjisë elektrike në Evropë shënuan rritje të konsiderueshme për shkak të rritjes së çmimeve të gazit natyror, rritja e kërkesës për shkak të kushteve atmosferike dhe rënies së prodhimit të energjisë së ripërtëritshme. Këta faktorë çojnë në rritjen e çmimeve të energjisë elektrike në disa tregje evropiane. Në muajin nëntor çmimi i energjisë elektrike u rrit për 64.7% në nivel vjetor.

Në muajin nëntor të vitit 2024, çmimet e metaleve bazë regjistruan ulje krahasuar me muajin paraprak, si për shembull ulje shënuan çmimet e: kallait për 7.4%, nikelit për 6.2%, bakrit për 4.8%, zinkut për 3.3%, plumbit për 2.3% dhe aluminit për 0.5%.

Këtë muaj edhe çmimet e metaleve të çmuara regjistruan uljen në nivel mujor, si për shembull çmimi i arit u ul për 1.4%, i platinut për 3.3% dhe i argjendit për 4.1%.

Në muajin nëntor, çmimi i misrit u rrit në nivel mujor për 5.8%, ndërsa çmimi i grurit u ul për 1.9%. Çmimi i farave të vajit të lulediellit u rrit për 5.1% në nivel mujor.

Tabela 1.1. Çmimet e energjisë në bursa (të dhëna mujore)

	Energjia elektrike (EUR/MWh)	Nafta bruto, Brent (\$/bbl)	Gazi natyror, Evropë (\$/1000 m3)
2023 I	148.7	83.1	714.1
II	146.2	82.7	585.1
III	113.4	78.5	488.7
IV	106.7	84.1	478.4
V	88.2	75.7	357.7
VI	96.6	74.9	366.2
VII	94.5	80.1	337.2
VIII	100.4	86.2	396
IX	103.8	94.0	408.6
X	104.9	91.1	515.5
XI	99.38	83.2	512.5
XII	81.72	77.9	407.1
2024 I	85.73	80.2	338.2
II	69.35	83.8	288.3
III	65.12	85.5	302.6
IV	61.96	90.5	321.4
V	72.2	82.0	358.2
VI	91.7	82.6	384.6
VII	135.5	85.3	366.1
VIII	120.8	80.9	437.8
IX	106.1	74.3	416.94
X	92.2	75.7	457.1
XI		74.4	492.7

Burimi: Banka Botërore, Bursa Hungareze e Energjisë Elektrike (World Bank, Hungarian Power Exchange)/



2. SHKËMBIMI I TREGTISË SË JASHTME

Shkëmbimi i përgjithshëm i tregtisë së jashtme në njëmbëdhjetë muajt e para të vitit 2024 ishte 17.343, 1 milionë euro, me një rënie prej 2.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në periudhën janar-nëntor të vitit 2024, pjesëmarrja e shkëmbimit tregtar të jashtëm me Bashkimin Evropian (BE 27), si partneri më i madh tregtar, është ulur për 0.2 p.p, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe është 61.7%. Gjermania është partneri më i rëndësishëm tregtar i vendit tonë. Në strukturën e përgjithshme të shkëmbimit të tregtisë së jashtme të vendit tonë, pesha e shkëmbimit tregtar me Gjermaninë në 11 muajt e parë të vitit 2024 është 23.1% dhe është ulur për 1.6 p.p., krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.




Eksporti

Vlera e mallrave të eksportuara në njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit 2024 është 7.216,6 milionë euro dhe shënoi rënie prej 5.8% (447.9 milionë euro), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, ndërsa vëllimi fizik i eksportit u rrit për 0.3%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Vlera e mallrave të eksportuara në muajin nëntor të vitit 2024 është 652.6 milionë euro dhe shënoi rënie për 9.2% (65.8 milionë euro), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa vëllimi fizik i eksportit u ul për 1.2%, krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023.

Analizuar në nivel mujor, në muajin nëntor të vitit 2024 eksporti shënoi rënie për 7.1% (50.2 milionë euro), krahasuar me muajin paraprak, edhe pse po kryhen rregullime sezonale të eksportit, ku ai regjistroi rënie mujore për 3.9%, që do të thotë ndikim negativ të faktorit sezonal (3.3 p.p.) kundrejt eksportit të këtij muaji.

Vlera e eksportit të produkteve ushqimore në njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit 2024 është rritur për 49.4 milionë euro, që do të thotë rritje prej 10.9% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, ndërsa sasia e eksportuar e produkteve ushqimore ka shënuar rritje për 12.1%. Në strukturën e përgjithshme të eksportit në vendin tonë, pjesëmarrja e produkteve ushqimore në njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit 2024 është 7.0% dhe është rritur për 1.1 p.p. krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit







2023. Në eksportin e përgjithshëm të produkteve ushqimore, pjesëmarrjen më të madhe të eksportit e zënë produktet e mëposhtme: frutat dhe perimet (46.7%), drithërat dhe produktet e drithërave (22.6), mishit dhe produkteve të mishit (7.6%), kafesë, çajit, kakaos dhe erëzave (6.5%)

Analizuar sipas grupimeve ekonomike³ të vendeve, në periudhën janar – nëntor të vitit 2024, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, eksportet kanë shënuar rënie në grupet: BE 27, EFTA, Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim nga Rajoni i Azisë-Paqësorit dhe rritje në grupimet: Ballkani Perëndimor, Zona e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut dhe Komonuelthi i Shteteve të Pavarura. Eksportet në 27 vendet e BE-së pësuan rënie prej 7.5% në nivel vjetor dhe paraqet 77% e eksporteve të përgjithshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa eksportet në vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rritje prej 6.2% dhe përfaqësonin 14.1% të eksportit të përgjithshëm në vendin tonë.

Importi

Vlera e mallrave të importuara në njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit 2024 është 10.126,5 milionë euro dhe shënoi rënie prej 0.6% (62.2 milionë euro) krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit 2023, ndërsa



vëllimi fizik i importeve shënoi rënie prej 5.8%.

Vlera e importeve në muajin nëntor të vitit 2024 është 936.9 milionë euro dhe shënuan rënie prej 2.1% (20.6 milionë euro), krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit 2023, ndërsa sasia e mallrave të importuara është ulur për 8.4%, krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023.

Analizuar në nivel mujor, në muajin nëntor të vitit 2024 importet shënuan rënie prej 4.7% (46,6 milionë euro) krahasuar me muajin paraparak, kryhen rregullime sezonale të importit, ku ai regjistron rënie mujore për 0.4%, që do të thotë ndikim negativ të faktorit sezonal (4.4 p.p.) kundrejt importit të këtij muaji.

Vlera e importit të produkteve ushqimore në njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit 2024 është rritur për 81.7 milionë euro, që paraqet rritje prej 9.2, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, ndërsa

³Grupimet ekonomike përfshijnë vendet e mëposhtme: BE 27 (Austri, Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Qipro, Republika Çeke, Gjermani, Danimarkë, Estoni, Spanjë, Finlandë, Francë, Greqi, Hungari, Irlandë, Itali, Lituan, Luksemburg, Letoni, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Suedia, Sllovenia dhe Sllovakia); EFTA (Zvicra, Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia); Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës (Emiratet e Bashkuara Arabe, Angola, Algjeria, Ekuador, Iraku, Irani, Kuvajti, Libia, Nigeria, Katari, Arabia Saudite dhe Venezuela); Ballkani Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia); Zona e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut (Kanada, Meksikë dhe Shtetet e Bashkuara); Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik Azi-Paqësor (Austri, Brunei, Kanada, Kili, Kinë, Hong Kong, Indonezi, Japoni, Kore, Meksikë, Malajzi, Zelanda e Re, Peru, Papua Guinea e Re, Filipinet, Rusia, Singapor, Tajlanda, Tajvani, Shtetet e Bashkuara dhe Vietnam) dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavarura (Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Kirgistani, Kazakistan, Moldavia, Rusia, Taxhikistani, Turkmenistani, Ukraina dhe Uzbekistani).



sasia e produkteve ushqimore të importuara u rrit për 6.4%. Në njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit 2024, përfaqësimi i produkteve ushqimore në strukturën e importit të përgjithshëm në vendin tonë është 9.6% dhe është rritur për 0.9 p.p., krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Në importet e përgjithshme të produkteve ushqimore, pjesëmarrje më të madhe kanë importet e produkteve të mëposhtme: mishi dhe produktet e mishit (21.7%), frutat dhe perimet (14.8%), drithërat dhe produktet e drithërave (13.4%), kafja, çaji, kakaoja dhe erëzat (11.7%), si dhe produktet e qumështit dhe vezët. (10.0).

Tabela 2.1. Pasqyra e eksporteve dhe importeve të produkteve të grupeve të përzgjedhura

Eksporti i naftës dhe produkteve të naftës*)					Im porti i naftës dhe produkteve të naftës*)				
	I-X I-2023	I-X I-2024	Saldo	Nom at në %		I-X I-2023	I-X I-2024	Saldo	Nom at në %
000 T	119,5	107,2	-12,3	-10,3	000 T	1.089,9	1.077,9	-12,0	-1,1
M il.EURO	94,6	75,7	-18,9	-20,0	M il.EURO	812,9	745,0	-67,9	-8,4
M il.\$	102,3	82,1	-20,2	-19,7	M il.\$	878,4	808,5	-69,8	-8,0

*)Të dhënat paraprake

Eksporti i produkteve k im ike*)					Im porti i produkteve k im ike*)				
	I-X I-2023	I-X I-2024	Saldo	Nom at në %		I-X I-2023	I-X I-2024	Saldo	Nom at në %
000 T	73,2	61,6	-11,6	-15,8	000 T	27,9	29,3	1,4	5,1
M il.EURO	2.202,6	1.701,3	-501,3	-22,8	M il.EURO	171,6	160,4	-11,2	-6,5
M il.\$	2.380,2	1.846,4	-533,8	-22,4	M il.\$	185,3	174,0	-11,3	-6,1

*)Të dhënat paraprake

Eksporti i hekurit dhe çelikut*)					Im porti i hekurit dhe çelikut*)				
	I-X I-2023	I-X I-2024	Saldo	Nom at në %		I-X I-2023	I-X I-2024	Saldo	Nom at në %
000 T	608,0	616,7	8,7	1,4	000 T	637,4	633,7	-3,7	-0,6
M il.EURO	535,9	473,5	-62,5	-11,7	M il.EURO	468,6	435,5	-33,1	-7,1
M il.\$	579,2	514,0	-65,1	-11,2	M il.\$	506,0	472,7	-33,2	-6,6


*)Të dhënat paraprake

Bilanci

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, deficitin tregtar është rritur me 15.3%, ose 385.7 milionë euro, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

Në nëntor të vitit 2024, deficitin tregtar u rrit me 18.9%, përkatësisht 45.2 milionë euro, krahasuar me nëntorin e vitit 2023.

Nëse analizojmë bilancin e eksporteve dhe importeve të mallrave sipas këndvështrimit ekonomik, rritja e deficitit është rezultat i rritjes së deficitit në shkëmbim me furnizimet industriale, mallrave të konsumit të ushqimeve dhe pijeve, si dhe nga zvogëlimi i bilancit pozitiv në shkëmbim me pajisje të transportit. Nga ana tjetër, në uljen e bilancit negativ ka ndikuar ulja e deficitit në shkëmbim me lëndë djegëse dhe lubrifikantëve dhe mallrave për investime, pa përfshirë pajisjet e transportit.



Në njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit 2024, 91.3% e deficitit tregtar të vendit është realizuar në shkëmbim me Mbretërinë e Madhe, Kinën dhe Greqinë, në vijim: me Turqinë, Poloninë, Italinë,



Serbinë, Bullgarinë e të tjera. Suficit u arrit në shkëmbim me Gjermaninë, Kosovën, Çekinë, Sllovakinë, Hungarinë, Spanjën dhe Rumaninë.

Struktura e valutës

Shikuar sipas strukturës valutore, 91.7% e shkëmbimeve tregtare në periudhën janar – nëntor të vitit 2024 është realizuar në euro, ku krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 paraqet rënie prej 0.1 p.p.. Në anën e eksportit dhe importit, valuata euro përfaqësohet përkatësisht me 94.5% dhe 89.8%, ku pesha e euros në eksporte u zvogëlua me 0.4 p.p., ndërsa në importe u rrit me 0.3 p.p. krahasuar me me periudhën janar - nëntor të vitit 2023.

Importi	I - XI - 2023					I - XI - 2024					ndryshim absolut në vlerën e valutës	ndryshimi relativ në vlerën e valutës (në %)
valuta	sasia, 000 t	importi në valutë	kursi mesatar i denarit kundrejt valutave	importi në denarë	strukt. në %	sasia, 000 t	importi në denarë	kursi mesatar i denarit kundrejt valutave	importi në denarë	strukt. në %		
EYP	5.537,3	9.119.564.959	61.5629	561.426.865.594	89,5	5.502,7	9.094.066.978	61.5353	559.606.139.732	89,8	-25.497.980	-0,3
USD	900,8	1.065.214.010	56,9986	60.715.707.245	9,7	556,2	1.023.598.476	56,7049	58.043.049.222	9,3	-41.615.534	-3,9
GBP	1,8	21.290.215	70,7327	1.505.914.374	0,2	2,4	21.301.302	72,5448	1.545.298.690	0,2	11.087	0,1
EURO+USD+GPB	6.4399			623.648.487.213	99,2	6.061,4			619.194.487.644	99,4		
vk eksporti	6.455,9			627.275.447.560	100,0	6.080,3			623.155.509.611	100,0		-0,7

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave dhe BPRMV-ja

3.SEKTORI FISKAL

Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2024 realizimi i përgjithshëm i të hyrave buxhetore të Buxhetit të RMV-së është 277.082 milionë denarë, që paraqet 87.1% të vlerës së planifikuar për vitin 2024, përkatësisht rritje prej 11.5% krahasuar me të hyrat e realizuara buxhetore në krahasim me të njëjtën periudhë nga viti 2023. Në kuadër të të hyrave të përgjithshme janë realizuar 256.743 milionë denarë në bazë të të hyrave tatimore dhe kontributeve sociale, ku norma e realizimit është 90.3% nga vlera e planifikuar për vitin 2024, përkatësisht rritje prej 14.6% krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu, janë realizuar të hyra tatimore në vlerë të përgjithshme prej 160.375 milionë denarëve (realizim prej 91.3% nga vlera e planifikuar për vitin 2024), ndërsa kontributet janë realizuar në vlerë prej 94.788 milionë denarëve (rritje vjetore prej 14.4%, përkatësisht 90.1 % e vlerës së planifikuar për vitin 2024). Në kuadër të të ardhurave tatimore, ka rritje të të ardhurave mbi bazë të: tatimit mbi të hyrat personale me 16.3%, tatimit mbi fitimin me 18.8%, tatimit mbi vlerën e shtuar me 19.3%, akcizës me 10.3% dhe detyrimeve të importit me 15.7%, ndërsa të hyrat e tjera tatimore janë ulur me 71.2%. Gjatë kësaj periudhe, të hyrat jotatimore shënuan rritje prej 6.4%, ndërsa të hyrat kapitale shënuan rënie prej 16.5%, si dhe të hyrat nga donacionet e huaja, të cilat shënuan rënie prej 63.4%.

Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme në periudhën janar - nëntor të vitit 2024 arrin në 306.738 milionë denarë, që paraqet 84.5% të planit vjetor, përkatësisht rritje prej 10.8%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Njëkohësisht, janë realizuar shpenzime rrjedhëse në vlerë prej 285.319 milionë denarëve përkatësisht 87.7% nga vlera e planifikuar për tërë vitin, që paraqet rritje prej 16.4%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Rritje kanë shënuar edhe shpenzimet për pagat dhe përfitimet me 18.7%, në shpenzimet për mallra dhe shërbime me 11.5%, dhe në shpenzimet për interesa me 37.4%. Transfertat, të cilat janë kategoria më e madhe e shpenzimeve aktuale (në vijim), u rritën me 15.1%, të nxitura nga rritja e transfertave sociale me 15.3%, shpenzimet e shëndetësisë me 13.3%, blloku dhe grantet e destinuara me 11.2%, dhe subvencionet dhe transfertat me 18.3%. Shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerë prej 21.419 milionë denarëve dhe janë 32.9% më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Norma e realizimit të shpenzimeve kapitale në periudhën janar - nëntor të vitit 2024 krahasuar me vlerën e planifikuar është 57.3%.




Tabela 3.1. Realizimi i Buxhetit të RMV-së për periudhën janar - nëntor të vitit 2024

	Rialokimi 2024	Janar-nëntor 2024		
	milione denarë	milione denarë	norma vjetore e rritjes (në %)	norma e realizimit
TË HYRAT E PËRGJITHSHME	318.151	277.082	11.5%	87.1%
Tatimet dhe kontributet	284.469	256.743	14.6%	90.3%
Tatimet	175.751	160.375	14.9%	91.3%
Tatimi mbi të hyrat personale	31.542	27.434	16.3%	87.0%
Tatimi mbi fitimin	21.118	18.545	18.8%	87.8%
TVSH	78.458	74.929	19.3%	95.5%
Akcizat	29.837	26.812	10.3%	89.9%
Detyrimet e importit	13.556	11.760	15.7%	86.8%
Të hyrat e tjera tatimore	1.240	895	-71.2%	72.2%
Kontributet	105.212	94.788	14.4%	90.1%
Të hyrat jotatimore	22.541	15.959	6.4%	70.8%
Të hyrat jotatimore	3.240	1.671	-16.5%	51.6%
Donacionet e huaja	7.900	2.709	-63.4%	34.3%
Të hyrat nga huat e paguara	0	0	/	/
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME	362.816	306.738	10.8%	84.5%
Shpenzimet rrjedhëse	325.443	285.319	16.4%	87.7%
Pagat dhe kompensimet	44.361	39.446	18.7%	88.9%
Mallërat dhe shërbimet	26.043	19.758	11.5%	75.9%
Transfertat	237.408	208.923	15.1%	88.0%
Transfertat sociale	173.432	154.615	15.3%	89.2%
FSPIMV	106.615	96.526	17.7%	90.5%
Kompensimet në para për personat e papunë	2.926	2.345	8.1%	80,1%
Ndihma sociale	15.314	13.518	6.6%	88.3%
Ndihma sociale	48.576	42.226	13.3%	86.9%
Trasferta të tjera	61.546	52.257	14.7%	84.9%
Interesi	17.632	17.192	37.4%	97.5%
Shpenzimet kapitale	37.374	21.419	-32.9%	57.3%
SALDOJA BUXHETORE	-44.666	-29.656	4.1%	66.4%




Burimi: Ministria e Financave

Grafiku 3.1. Struktura e të hyrave të tjera tatimore të realizuara, janar – nëntor 2024



Burimi: Ministria e Financave


Grafiku 3.2. Struktura e shpenzimeve të reaalizuara sipas klasifikimit ekonomik, janar – nëntor 2024



Burimi: Ministria e Financave

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, është realizuar deficiti buxhetor i RMV-së prej 29.656 milionë denarëve, që paraqet 3.1% të PBB-së e parashikuar për vitin 2024, përkatësisht 66.4% nga plani vjetor.

Grafiku 3.3. Deficiti buxhetor, të dhënat kumulative (mil. denarë)




Burimi: MF

Shpenzime sipas shfrytëzuesve buxhetorë

Në vijim është dhënë pasqyrë e shpenzimeve buxhetore për shfrytëzuesit më të mëdhenj buxhetorë. Në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë ka realizuar 62.473 milionë denarë ose 91.7% nga buxheti i përgjithshëm për vitin aktual. Po ashtu, pjesa më e madhe (69.8%) e shpenzimeve janë të dedikuara për transfera rrjedhëse në fondet jashtëbuxhetore, për të cilat janë shpenzuar 43.589 milionë denarë përkatësisht 93.9%

Grafiku 3.4: Struktura e shpenzimeve sipas shfrytëzuesve buxhetorë dhe ndarjeve (nëntor 2024)



Burimi: MF



nga mjetet e parapara për vitin 2024. Zëri i dytë më i rëndësishëm i shpenzimeve janë përfitimet sociale, me pjesëmarrje prej 21.2% nga shpenzimet e përgjithshme dhe për këtë qëllim janë realizuar 91.1% (13.265 milionë denarë) nga planifikimi për vitin 2024.

Në periudhën e analizuar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka realizuar mjete buxhetore në vlerë prej 31.112 milionë denarëve, që është 86.1% e buxhetit të përgjithshëm për vitin 2024. Pjesa më e madhe e shpenzimeve (57.9%) paraqesin transferta rrjedhëse në NJVL, për të cilat janë shpenzuar 20.332 milionë denarë, përkatësisht 90.4% e mjeteve të përgjithshme të planifikuara. Pagat dhe kompensimet janë zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 19.9%, për të cilat janë shpenzuar 6.980 milionë denarë, përkatësisht 88.8% e mjeteve të përgjithshme të planifikuara.

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, Ministria e Punëve të Brendshme ka realizuar gjithsej 12.939 milionë denarë, që paraqet 84.6% të buxhetit të saj (vetanak) për vitin 2024. Shpenzimet më të theksuara janë pagat dhe kompensimet me pjesëmarrje prej 68.1%, për të cilat janë shpenzuar 8.817 milionë denarë ose 90.3% nga vlera e planifikuar. Zëri i dytë më i rëndësishëm janë mallrat dhe shërbimet me pjesëmarrje prej 19.5%. Për këtë qëllim janë realizuar 2.521 milionë denarë përkatësisht 80.3% nga plani vjetor.

Në këtë periudhë Agjencia e Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (APFBZHR) ka realizuar 7.441 milionë denarë, që paraqet 72.0% të mjeteve të planifikuara për vitin aktual. Për subvencionet dhe transfertat, të cilët janë pjesëmarrës me vlerë 91.5% në shpenzimet e përgjithshme, të realizuar janë 72.7% nga mjetet e planifikuara për tërë vitin, përkatësisht 6.807 milionë denarë.

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, Ministria e Mbrojtjes ka realizuar 14.804 milionë denarë, që është 83.3% nga Buxheti i përgjithshëm për këtë vit. Pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet e kanë pagat dhe kompensimet me 37.5%, për atë qëllim realizimi arrin në 5.548 milionë denarë (88.1% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara për vitin aktual). Shpenzimet kapitale me pjesëmarrje prej 29.5% nga shpenzimet e përgjithshme dhe për këtë zë janë shpenzuar 4.365 milionë denarë, përkatësisht 82.4% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara.

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka realizuar gjithsej 3.038 milionë denarë, pikërisht 68.4% nga mjetet e planifikuara për vitin 2024. Po ashtu, subvencionet dhe kompensimet përbëjnë 56.9% nga shpenzimet e përgjithme të këtij shfrytëzuesi buxhetor dhe janë realizuar në vlerë prej 1.729 milionë denarëve (60.8% nga mjetet e planifikuara).

Në periudhën e analizuar, Ministria e Shëndetësisë ka shpenzuar mjete buxhetore në vlerë prej 6.598 milionë denarëve përkatësisht 80.1% nga buxheti i përgjithshëm për vitin 2024. Pjesën më të madhe në shpenzime e kanë transfertat rrjedhëse në fondet jashtëbuxhetore me 52.8%, për të cilat janë shpenzuar 3.486 milionë denarë ose 85.4% nga mjetet e ndara për vitin 2024. Zëri i dytë më i rëndësishëm është për mallra dhe shërbime me realizim prej 2.562 milionë denarëve (79.3% nga sa është planifikuar për vitin) dhe pjesëmarrje me 38.8% në shpenzimet e përgjithshme.

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve ka realizuar mjete në vlerë prej 4.728 milionë denarëve, që është 45.5% e buxhetit të përgjithshëm për vitin aktual. Realizimi i shpenzimeve kapitale si zë kryesor është 80.5% nga mjetet e përgjithshme të realizuara të këtij shfrytëzuesi buxhetor (3.805 milionë denarë ose 41.8% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara).

Në këtë periudhë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave ka realizuar mjete në vlerë prej 1.391 milionë denarëve, që paraqet 81.2% nga ato të planifikuara për vitin 2024. Pagat dhe kompensimet (579 milionë denarë) janë zëri më i rëndësishëm në shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor me pjesëmarrje prej 41.6%, ndërsa janë realizuar 89.3% nga të planifikuarat. Subvencionet dhe transfertat me pjesëmarrje prej 20.7% nga shpenzimet e përgjithshme, ndërsa realizimi për këtë qëllim është 288 milionë denarë përkatësisht 93.2% nga buxheti i përgjithshëm për këtë qëllim.

Të dhënat e detajuara për secilin shfrytëzues buxhetor janë paraqitur në shtojcën statistikore në linkun në vijim (http://finance.gov.mk/lëvizjet_e_shkurtra-ekonomike-ked-me/)



4. SEKTORI SOCIAL

Personat e sapopunësuar dhe të regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit

Në njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit 2024, në Agjencinë e Punësimit janë regjistruar gjithsej 174.617 marrëdhënie pune të sapokrijuara. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, numri i përgjithshëm i të punësuarve të rinj është ulur me 8.4%.

Nga numri i përgjithshëm i të papunëve të rinj, 41.4% janë të punësuar me kohë të pacaktuar, ndërsa pjesa tjetër me kohë të caktuar dhe për kryerjen e punëve sezonale. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve të rinj, përkatësisht në muajin nëntor të vitit 2024, 17.2% janë nga evidentimi i papunësisë.




Numri i përgjithshëm i të papunëve në muajin nëntor të vitit 2024 është 141.539, nga të cilët 97.753 janë kërkuesë aktivë të punës, ndërsa 43.786 janë pjesa tjetër e personave të papunë. Në bazë vjetore, numri i përgjithshëm i personave të papunë është ulur për 4.0%, ndërsa duke filluar nga muaji maj i vitit 2021, ai shënoi rënie vjetore të vazhdueshme. Krahasur me muajin tetor të vitit 2024, numri i të papunëve është ulur për 67 persona.

Pjesa më e madhe e personave aktivë të papunë (58.9%) janë persona që jetojnë në qytet, ndërsa sipas strukturës gjinore 47.9% janë meshkuj. Sipas shkallës së arsimit, pjesa më e madhe e personave të papunë, përkatësisht 68.9% kanë arsim të mesëm jo të plotë ose më pak se aq, 23.7% me arsim të mesëm të përfunduar, ndërsa 7.4% me arsim të lartë ose më të lartë.

Analizuar sipas strukturës së moshës, 49.6% e të papunëve bëjnë pjesë në grupin e moshës madhore nga 25 deri 49 vjeç. Sipas kohës së pritjes të të papunëve, 59.3% e personave të papunë presin të punësohen nga 1 deri në 7 vjet, ndërsa 13.4% presin 8 vjet ose më shumë.

Pagat

Sipas raportit të Entit Shtetëror të Statistikave, paga/neto mesatare nominale në muajin tetor të vitit 2024 ishte 42.134 denarë dhe shënoi rritje vjetore prej 8.5%, ndërsa krahasuar me muajin shtator të vitit 2024 ajo ishte më e lartë për 1.3%. Rritje më të madhe të pagës/neto mesatare krahasuar me muajin tetor 2023 u shënuar në sektorët e





mëposhtëm: art, argëtim dhe rekreacion (11.5%), informacion dhe komunikim (10.7%) dhe arsim (10.5%). Në muajin tetor të vitit 2024, pagat reale shënuan rritje vjetore prej 4.8%.

Paga/neto mesatare më e lartë është paguar në muajin tetor të vitit 2024 në sektorin e informacionit dhe komunikimit (78.426 denarë), në kuadër të të cilit vlerë më të lartë të pagës neto është paguar në veprimtarinë e programimit kompjuterik, konsultimeve dhe veprimtarive të ndërlidhura (97.404 denarë), më pas ndjekin veprimtaritë financiare dhe veprimaritetë e sigurimve me 57.462 denarë, sektori minieraleve dhe guroreve me pagë/neto mesatare me 54.271 denarë dhe sektori i furnizimit të energjisë elektrike, gazit, ngrohjes dhe klimatizimit me 54.052 denarë.




Paga/neto mesatare nominale në muajin tetor të vitit 2024 ishte 63.392 denarë dhe krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2023 ka rritje për 8.6%, ndërsa në bazë mujore ajo është më e lartë për 1.3%. Rritja më e ulët e pagës/neto mesatare në muajin tetor të vitit 2024, krahasuar me muajin tetor të vitit 2023 u shënu në sektorët: art, argëtim dhe rekreacion (11.7%), industria prodhues (10.8%) dhe arsim (10.8%).

Pensionet

Në muajin nëntor të vitit 2024, në Fondin Pensional dhe Invalidor janë evidentuar 339.955 pensionistë. Në shtator të vitit 2024 u ndryshua Ligji i Sigurimit Pensional dhe Invalidor, ku sipas të cilit, më datën 1.10.2024 kishte rritje lineare për të gjitha llojet e pensioneve për 2.500 denarë. Nga numri i përgjithshëm i pensionistëve, 71.0% janë shfrytëzues të pensionit të pleqërisë ose 241.400 pensionistë, 21.5% pensione familjar ose 73.113 pensionistë dhe 7.5 pensione invaliditeti ose 25.442 pensionistë.

Pensioni mesatar në nëntor 2024 është 23.763 denarë, ose 17,7% më i lartë se i njëjti muaj i vitit 2023⁴. Rritja e pensioneve, ndër të tjera, vjen si rezultat i përshtatjes së pensioneve në muajin mars, sipas metodologjisë që parasheh rregullimin e pensioneve me model të kombinuar

⁴ Në llogaritjen e pensionit mesatar nuk përfshihen pensionet ushtarake dhe ato bujqësore.





prej 50% rritje të pagës mesatare dhe 50% rritje të kostos së jetesës, sipas të dhënave zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikave. Sipas kësaj metodologjie, duke filluar nga marsi 2022, rregullimi kryhet dy herë në vit, pra në muajt mars dhe shtator.

Raporti i pensionit mesatar me pagën e paguar mesatare në muajin tetor të vitit 2024 (të dhënat e fundit në dispozicion) është 56,3%.

Pensionin mesatar i pleqërisë në muajin nëntor të vitit 2024 është 25.404, pensionin mesatar invalidor është 21.303 denarë, ndërsa pensionin mesatar familjar 19.200 denarë. Për pagesën e pensioneve këtë muaj janë harxhuar 8.061 milionë denarë, që paraqet 52,0% nga transfertat e përgjithshme sociale.


Tabela 4.1 Të dhënat e të ardhurave pensionale për muajin nëntor të vitit 2024

Shfrytëzuesit e pensionit	numër	struktura	pensionin mesatar
pleqërie	241.400	71,0%	25.404,00
invaliditeti	25.442	7,5%	21.301,00
familjar	73.113	21,5%	19.200,00
Gjithsej	339.955	100,0%	23.763,00
Shfrytëzuesit e minimumit.			
pensionet bujqësore	37		13.429,00
Shfrytëzuesit e pikëve pensionale			
	729		32.386,00
Gjithsej	340.721		23.780,00
Burimi: Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut			

5. SEKTORI MONETAR FINANCIAR

Në muajin nëntor të vitit 2024, Banka Popullore e mbajti normën bazë të interesit në nivel prej 5,80%, pasi kishte filluar ta ulë atë në dy muajt paraprak. Vendimi për lehtësimin e politikave monetare bazohet në vlerësimin e inflacionit në zhvillimet më të fundit të treguesve kryesorë makroekonomikë dhe në lëvizjet e favorshme në tregun valutor. Ky reduktim është në përputhje me politikën monetare të BQE-së, e cila filloi uljen e normave të interesit në shtator të vitit 2024.

Në muajin nëntor të vitit 2024, Banka Popullore i ka mbajtur depozitat njëditore dhe shtatëditore të disponueshme, respektivisht në nivel 4,20% dhe 4,25%





Paratë primare

Në muajin nëntor të vitit 2024, paratë primare⁵ janë ulur për 8,0% në nivel mujor. Rënia e parave primare vjen si pasojë e rënies së mjeteve të përgjithshme likuide për 14.8%, ndërsa të parave të gatshme janë ulur për 0.2%.

Në muajin nëntor të vitit 2024, paratë primare janë rritur për 7.5% në nivel vjetor, si pasojë e parave të gatshme në qarkullim dhe mjetet e përgjithshme likuide, respektivisht për 11.2% dhe 3.8%.

Potenciali i depozitave⁶

Në muajin nëntor të vitit 2024, depozitat e përgjithshme në banka janë rritur për 0.9% në nivel vjetor. Analiza sektoriale tregon se krahasuar me muajin e kaluar depozitat familjare janë rritur për 1.9%, ndërsa depozitat e kompanive kanë regjistruar ulje për 0.6%.

Nga aspekti i valutës, në muajin nëntor të vitit 2024 krahasuar me muajin parapark, depozitat familjare dhe valutat e huaja regjistruan rritje, respektivisht 1.6% dhe 0.1%.

Në muajin nëntor të vitit 2024, potenciali i përgjithshëm i depozitave regjistroi rritje prej 11.0% në nivel vjetor. Analizuar sipas valutave, depozitat në valutë vendore janë rritur për 16.2%, ndërsa depozitat në valutë të huaj për 4.5%.

Nga aspekti sektorial, depozitat e kompanive kanë regjistruar rritje për 7.0% në nivel vjetor, ndërsa depozitat familjare kanë regjistruar rritje prej 13.3%.




Tabela 5.1. Potenciali i depozitave dhe kreditore në sektorin privat

Potenciali i depozitave dhe kreditore në sektorin privat (nëntor 2024)	Në miliona denarë	Ndryshimi mujor	Ndryshimi vjetor
Potenciali i depozitave	570.298	0.9%	11.0%
Sipas valutës:			
Denarë	332.336	1.6%	16.2%
Valutë e huaj	237.963	0.1%	4.5%
Sipas afatit:			
Afatshkurtër	214.595	-0.4%	-1.1%
Afatgjatë	145.904	2.1%	27.1%

⁵ Paratë primare llogariten si shuma e parave të gatshme në qarkullim (përfshirë paratë në thesar), rezerva e detyrueshme në denarë dhe në valutë dhe teprica e mjeteve likuide mbi detyrimin për rezervën e detyrueshme.

⁶BPRMV publikoi të dhëna nga statistikave monetare, statistikave të institucioneve të tjera financiare dhe statistikave për normat e interesit, sipas një metodologjie të re. Ndryshimet metodologjike u bënë për t'u përfaqësuar me rekomandimet e Manualit dhe Udhëzimeve të Statistikave Monetare dhe Financiare të sapobotuar të FMN-së 2016 (MFSMCG – FMN, 2016) dhe Misionit Teknik të FMN-së në fushën e statistikave monetare dhe financiare në BPRMV 2015.



Kreditë në sektorin privat	481.410	0.7%	9.7%
Sipas valutës			
Denarë	295.096	0,8%	16,0%
Valutë e huaj	186.315	0.7%	0.9%
Sipas afatit:			
Afatshkurtër	69.545	-0.7%	8.5%
Afatgjatë	394.978	0.9%	10.6%

Burimi: BPRMV

Sipas maturimit, depozitat afatshkurtra u rritën në nivel vjetor për 1.1%, ndërsa depozitat afatgjate u rritën për 27.1%.

Struktura valutore e depozitave vazhdon të mbetet e qëndrueshme, me ç'rast pjesëmarrja në depozita në valutë vendore dominon bazën e depozitave dhe është 58.3% dhe këtë muaj ka shënuar përsëri rritje.

Kreditë bankare

Në muajin nëntor të vitit 2024, kreditë e përgjithshme bankare në sektorin privat janë rritur për 0.7% në nivel mujor, në kushtet e rritjes së kredimitit të familjeve dhe kompanive, respektivisht për 0.7 dhe 0.8%.

Nga aspekti i valutor, në nivel mujor kreditë në denarë shënuan rritje për 0.8%, ndërsa kreditë devizore janë regjistruar rritje prej 0.7%.


Në bazë vjetore, në muajin nëntor të vitit 2024 kreditë e përgjithshme janë rritur për 9.7%, në kushtet e rritjes së kredive të kompanive dhe kredive ndaj familjeve, përkatësisht për 11.5% dhe 8.2%. Kreditë në valutën vendore janë rritur për 16.0%, ndërsa kreditë në valutë të huaj kanë regjistruar rritje për 0.9%.

Nga aspekti i maturimit, kreditë afatgjate shënuan rritje vjetore prej 10.6%, ndërsa kreditë afatshkurtëra prej 8.5%.

Normat e interesit të depozitave bankare

Në muajin nëntor të vitit 2024, norma e interesit të përgjithshëm të kredive u ul për 0.02% p.p krahasuar me muajin paraprak dhe ajo ishte 5.36%. Normat e interesit të kredive në denarë u ul për 0.01 p.p. dhe është 5.80%, ndërsa norma e interesit të kredive divizore regjistroi rënie prej 0.02 p.p dhe është 4.75%.

Në muajin nëntor të vitit 2024, norma e interesit të përgjithshëm të depozitave u rrit për 0.05% p.p. krahasuar me muajin paraprak dhe është 2.12%. Normat e interesit të depozitave në denarë janë rritur për 0.07 p.p. dhe është 2.63%, ndërsa depozitat devizore për 0.05 p.p. dhe është 1.66%.






Norma e interesit e kredive të sapomiratuara është 5.16%, ndërsa kreditë devizore të reja të sapomiratuara janë 3.94%. Normat e interesave të depozitave devizore të sapomiratuara në denarë dhe në deviza janë përkatësisht 3.21% dhe 2.27%.

Tregu i kapitalit

Në tregun e kapitalit, qarkullimi i përgjithshëm në bursë në muajin nëntor të vitit 2024 u rrit për 33% në nivel mujor, si rezultat i rritjes së qarkullimit të transaksioneve bllok për 12.4%, ndërsa qarkullimi nga tregtia klasike u ul 4.1%.

Qarkullimi i përgjithshëm i bursës në muajin nëntor të vitit 2024 është 2.541,5 milionë denarë, që do të thotë rritje për 693,9% në nivel vjetor.

Në fund të muajit nëntor të vitit 2024, indeksi i bursës së Maqedonisë (IBM) është 9.109,4 pikë indeksi, me ç'rast në nivel mujor është rritur për 5.7%, ndërsa krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, indeksi është rritur për 50.7%



Rezervat devizore

Vlera e rezervave devizore bruto në fund të muajit nëntor të vitit 2024 është 4.919,96 miliona euro dhe krahasuar me muajin paraprak u ul për 1.1%, ndërsa krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023 rezervat devizore u rritën për 24.1%.